



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Mbrojtjes  
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Mbrojtjes shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

<b>Titulli i pozitës së punës</b>	Drejtor i Departamentit Ligjor
<b>Klasa e pozitës</b>	Drejtues i Mesëm 1
<b>Koeficienti/Paga</b>	A5
<b>Nr. i kërkuar</b>	1
<b>Data e njoftimit</b>	08/11/2021
<b>Afati për aplikim</b>	23/11/2021 - 30/11/2021
<b>Institucioni</b>	Ministria e Mbrojtjes
<b>Departamenti</b>	Zyra e Sekretarit
<b>Divizioni</b>	
<b>Vendi i punës</b>	
<b>Nr. i Referencës</b>	RN00007823
<b>Kodi</b>	RPC0001632



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Udhëheq Departamentin dhe cakton objektivat e tij në pajtim me objektivat strategjike të Ministrisë dhe harton plane vjetore të punës, të detajuara për përmbushjen e këtyre objektivave;
- Siguron dhe koordinon harmonizimin e dokumenteve strategjike nga fushëveprimi i Ministrisë dhe FSK-së me legjislacionin në fuqi;
- Harton Planin Legjislativ në konsultim me drejtuesin e lartë dhe udhëheqësin politik të Ministrisë, si dhe njësitë tjera organizative të Ministrisë;
- Siguron hartimin, monitorimin dhe harmonizimin e legjislacionit parësor dhe dytësor nga fushëveprimi i Ministrisë dhe FSK-së me vetiniciativë apo mbi bazën e kërkesave, si dhe respektimin e teknikave dhe standardeve të hartimit të legjislacionit;
- Siguron mbështetje ligjore në hartimin dhe negocimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ndërinstitucionale, memorandumeve të bashkëpunimit dhe propozim kontratave;
- Siguron përafrimin e legjislacionit të Ministrisë dhe FSK-së me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*) si dhe me ligjet e aplikueshme në Kosovë
- Siguron bashkëpunimin me Avokaturën Shtetërore/Ministrinë e Drejtësisë për përfaqësimin e Ministrisë dhe FSK-së në kontestet gjyqësore dhe bashkërendon aktivitetet ndërinstitucionale, si dhe me Zyrën Ligjore të FSK-së;
- Siguron mbështetje ligjore, opinione, këshilla dhe rekomandime ligjore për të gjitha strukturat në MM-së dhe FSK-së;
- Bashkëpunon me Qeverinë, Kuvendin e Kosovës dhe institucionet tjera për koordinimin e aktiviteteve legjislative;
- Menaxhon me stafin e departamentit, bën ndarjen e detyrave, ofron udhëzime dhe monitoron punën e tyre, bënë vlerësimin e rregullt të stafit të departamentit, si dhe përkrah zhvillimin e tyre përmes trajnimeve;

## 2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të Fakulteti Juridik –jurist i diplomuar me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku shtatë (7) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku pesë (5) vite në pozita drejtuese.



## 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë dhe legjislacionit të aplikueshëm të Republikës së Kosovës;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punë, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim, negociim dhe aftësi bindëse në menaxhim;
- 

## 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 07/12/2021, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- Ne Ministrinë e Mbrojtjes, kandidatet do të njoftohen me kohë

## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme në fushat e përgjegjësisë së ministrisë dhe legjislacionit të aplikueshëm të Republikës së Kosovës

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranojnë dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

